- Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.9, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi rezulton se analizat e çmimeve janë hartuar në kundërshtim me parashikimet e VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pasi në dokumentin e analizës së cmimit ora e punëtorisë është vendosur 185 lekë kjo në kundërshtim me VKM e sipërcituar e cila ka hyrë në fuqi dhe është e detyrueshme për tu zbatuar që me datë 01.04.2023. Gjithashtu çmimet e paraqitura në preventiv nuk përkojnë me vlerat e analizës së çmimeve për disa nga zërat e preventivit. Në përfundim, duke patur në konsideratë faktin se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DT janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës me qëllim kualifikimin e tyre në një procedurë prokurimi dhe në kushtet kur mangësitë e konstatuara janë të natyrave të ndryshme dhe të thelbësore, KVO vlerëson se oferta e paraqitur nga BOE nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe për rrjedhojë kjo ofertë skualifikohet.

7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SALILLARI” sh.p.k., me NUIS J62903125G dhe “BAJRAMI N.” sh.p.k., me NUIS K02727202O, kanë mangësitë si më poshtë vijon :

A) Për plotësimin e kërkesës për kualifikim lidhur me përvojën e suksesshme në kontrata të mëparshme, sipas pikës 2.3.1. të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik) të DT, operatori ekonomik “SALILLARI” sh.p.k., në cilësinë e anëtarit të BOE ofertues në këtë procedurë dhe në përputhje me përqindjen e deklaruar të pjesëmarrjes në kontratë, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

I) Kontratën për kryerjen e punimeve të ndërtimit lidhur me projektin “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë”, kontratë kjo e lidhur ndërmjet shoqërisë koncesionare “Albanian Highway Concession” sh.p.k. dhe “SALILLARI” sh.p.k.

Nisur nga vlera e kontratës, KVO evidenton se ky dokumentacion është paraqitur në përmbushje të kërkesës për kualifikim sipas pikës 2.3.1./a, ku kërkohet që OE ofertues të vërtetojnë se kanë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vlerësimi i kësaj kontrate u bë në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara në dokumentet e tenderit të procedurës në fjalë, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementët e :

- i) kohës;
- ii) vlerës dhe
- iii) natyrës së ngjashme.

Pra, (i) punimet për objektin e paraqitur duhet të jenë realizuar brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë vlerën/madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm përvojën e paraqitur nga operatori ekonomik ofertues.

Konkretisht, punimet e kontratës së paraqitur nga operatori ekonomik “SALILLARI” sh.p.k., nuk mund të konsiderohen si punë të ngjashme me punimet objekt kontrate, pasi nuk përmbushin

karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objektit të paraqitur nga OE nuk është e ngjashme, pasi punimet objekt prokurimi janë të një natyre të ndryshme, konkretisht objekti i prokurimit përfshin ndërtimin e një hangari për helikopterë, ndërsa kontrata e paraqitur përfshin punime për ndërtim sheshesh, rrugësh, urash dhe rehabilitim/mirëmbajtjen e tyre.

Në vijim të këtij arsyetimi, KVO vlerëson se kjo kontratë nuk mund të konsiderohet kontratë e ngjashme pasi pikat e kërkuara të licencës për zbatimin e punimeve të kontratës objekt prokurimi, nuk përkojnë me pikat e licencës së punës se ngjashme të paraqitur dhe nga kqyrja e preventivit vërehet se pjesa dërrmuese e punimeve janë punime rruge të cilat nuk përkojnë me zërat e preventivit të kërkuara në procedurën që autoriteti kontraktor zhvillon.

Në përfundim, KVO gjykon/vlerëson se kontrata e paraqitur nga ofertuesi nuk përmbush këto karakteristika në natyrë, kompleksitet dhe metodologji.

II) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtari tjetër i BOE, rezulton se shoqëria "SALILLARI" sh.p.k. ka realizuar 52% të punimeve të kontratës me objekt "Rivitalizimi urban dhe përmirësimi i aksesit në zonat me aktivitet bujqësor në Rajonin 3", nënobjekti "Rikonstruksion i rrugës Kuqan-Jagodinë-Muriqan-Thanë" dhe "Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga rrugët F. Noli, M. Plepi, A. Bektashi dhe rivitalizimi i parkut Rinia". Vlera e përgjithshme e kontratës sipas Formularit të Vlerësimit, bashkëlidhur shkresës së FSHZH nr. 251/1, datë 17.02.2021 është 240,080,307 lekë me T.V.SH. dhe realizimi në përqindje është respektivisht si më poshtë:

- shoqëria "BAJRAMI N." shpk 48% dhe
- shoqëria "SALILLARI" shpk 52%.

Në kushtet kur me kontratën e paraqitur me objekt "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë", OE "SALILLARI" sh.p.k. nuk ka arritur të plotësojë kërkesën për kualifikim për kontrata të ngjashme, KVO vendosi që në funksion të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i BOE (shoqëria "SALILLARI" sh.p.k.), të konsiderojë edhe kontratën si më sipër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj kontrate, rezulton se :

- punimet janë realizuar brenda afatit të përcaktuar;
- ka disa zëra punimesh që konsiderohen të ngjashme, por
- nuk arrin vlerën e kërkuar, pasi si një kontratë e vetme, vlera e realizuar e punimeve duhet të jetë jo më e ulët se 50% e F.L. Konkretisht vlera e kërkuar është  $(407,623,670 / 2 = 203,811,835$  lekë) dhe specifikisht për OE "SALILLARI" sh.p.k., në cilësinë e anëtarit të BOE me një pjesëmarrje prej 88%, vlera e kërkuar e punimeve të ngjashme për një kontratë të vetme është 179,354,415 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i dërguar rezulton se OE "SALILLARI" sh.p.k., ka realizuar 52% të vlerës së punimeve ose 124,841,760 lekë me TVSH, vlerë kjo më e ulët se vlera e kërkuar.

Nga shqyrtimi i kontratave të paraqitura nga ofertuesi rezulton se këto kontrata nuk plotësojnë vlerën sipas përqindjes as për shkronjën a) dhe as për shkronjën b), të pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuar në DT.

Për sa më sipër ky ofertues nuk arrin të plotësojë kërkesën për kualifikim lidhur me përvojën e suksesshme në kontrata të mëparshme, sipas pikës 2.3.1. të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik) të DT

B) Sipas ndarjes së punimeve që të dy anëtarët e BOE kanë përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, OE "SALILLARI" shpk, ka marrë përsipër të realizojë të gjitha punimet ndërtimore dhe në raport me këto angazhime ka detyrimin që të plotësojë edhe kërkesat për kualifikim përfshirë kërkesat për kapacitetet tekniko-profesionale. Në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", rezulton

se ky ofertues ka nuk ka deklaruar asnjë specialist “Karpentier”, nga dy që kërkohen sipas pikës 2.3.3. të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit.

Kërkesa për këta specialistë referuar përcaktimit në DT është parashikuar të përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST dhe dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu XI - Kushte të përgjithshme për zbatim, neni 88 - Bashkimi i operatorëve ekonomikë, ku shprehimisht përcaktohet si vijon:

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Për sa më sipër, BOE me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesës për kualifikim lidhur me punonjësit e kualifikuar.

C) BOE me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesave për kualifikim sipas pikave 2.3.5, 2.3.6 dhe 2.3.7. të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim, të DT, pasi ka këto mangësi:

I) Autorizimet e prodhuesit që janë paraqitur janë fotokopje të papërkthyer në gjuhën shqipe, gjë që bie në kundërshtim me parashikimet e dokumenteve të tenderit. Konkretisht, në pikën 4.7 të Seksionit 4 të Dokumenteve të Tenderit, është përcaktuar se gjuha në të cilën mund të hartohen ofertat është gjuha shqipe dhe në vijim lidhur me gjuhën e ofertave dhe origjinalitetin e dokumenteve në shtojcën 7 të DT parashikohet se :

- nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip dhe
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

II) Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për disa nga pajisjet e skedës teknike, konkretisht artikuj me nr. rendor nga 13 deri në 21, për të cilët është deklaruar se janë produkte të shoqërisë Viking Corporation, por nuk ka paraqitur autorizim nga kjo shoqëri për ofertuesin (BOE). Sa më sipër bie në kundërshtim me parashikimet e pikës 2.3.5. të KVK, cituar:

2.3.5 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga *prodhuesit* ose nga *distributorët e autorizuar nga prodhuesit*, për tregtimin e artikujve/pajisjeve që do të përdoren në funksion të realizimit të zërave përkatës të preventivit të punimeve (sipas listës së përcaktuar në pikën 2.3.6, të DT). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

III) Për pajisjen “Rack/Kabinet 42U i kompletuar me Fan, Tabaka, Sistemues, etj. ose ekuivalente” është deklaruar prodhuesi, Canovate dhe si distributor është ITE Group.

Nga verifikimi i dokumentacioni të kërkuar vërehet së mungon autorizimi nga Canovate për ITE Group. Kjo në kundërshtim me kërkesën e pikës 2.3.5. të KVK.

IV) Për sa i përket pajisjes “Pompë mbrojtëse kundër zjarrit” është paraqitur katalogu përkatës, ku në faqen 2/7 te katalogut përcaktohet që kjo pompë është 100% për ujë. Kjo në kundërshtim me kërkesat e DT ku është kërkuar që kjo pompë do të jetë pompë shkume për shuarjen e zjarrit. Kjo theksohet edhe në faqen 7 të katalogut (faqja 12 e dokumentit ne pdf) ku edhe këtu cilësohet që furnizimi i kësaj pompe është 100% ujë.

D) Lidhur me kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.9. të KVK të DT cituar:

*2.3.9 Për ato zëra punësh që nuk ndodhen në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ofertuesit duhet të paraqesin analizat teknike të tyre, sipas formatit të miratuar.*

konstatohet se analizat e çmimeve janë hartuar në kundërshtim me parashikimet e VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pasi në dokumentin e analizës së çmimit ora e punëtorisë është vendosur 185 lekë kjo në kundërshtim me VKM e sipërcituar e cila ka hyrë në fuqi dhe është e detyrueshme për tu zbatuar që me datë 01.04.2023.

Gjithashtu çmimet e paraqitura në preventiv nuk përkojnë me vlerat e analizës së çmimeve për disa nga zërat e preventivit.

Në përfundim, duke patur në kosnideratë faktin se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DT janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës me qëllim kualifikimin e tyre në një procedurë prokurimi dhe në kushtet kur mangësitë e konstatuara janë të natyrave të ndryshme dhe të thelbësore, KVO vlerëson se oferta e paraqitur nga BOE nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhojë kjo ofertë skualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomikë si vijon :

- “AGRI CONSTRUCTION” sh.p.k., me NUIS K01725001F dhe adresë : Tiranë, Rruga e Dibrës, ish Truproja e Shkollës “Skënderbej”, nr. 3 dhe
- “ALKO-IMPEX General Construcion” d.sh.h., me NUIS K91326028I dhe adresë : Tiranë, Rruga Reshit Petrela, Kompleksi Usluga, kati i 8-të, pranë stacionit të trenit,

se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 384,361,462 (treqind e tetëdhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës (ish shkolla e Bashkuar), Tiranë, me numër kontakti 042 226 601/2/3, 1320, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak) :



PO  JO **AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

Drejtuar: BOE "GJOKA KONSTRUKSION & SELAMI"  
Nr.6, Rruga Dora D'Istria, Tiranë 1001

Procedura e prokurimit/lotit: "E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike"

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-64084-03-29-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Sistemim asfaltim rruga Ura e Cerencit – Peshkopi (Peshkopi – Maqellarë), Loti 3"

Fondi limit: 1,249,458,590.51 (një miliard e dyqind e dyzet e nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë pikë pesëdhjetë e një) Lekë pa TVSH.

Në Euro: 10,962,086.25 (dhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) EUR pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 muaj

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*):

Buletini i Njoftimeve Publike: *Buletini i Njoftimeve Publike, data 03 Prill 2023, nr. 30*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. 2 T

K01731001M

Vlera: 1,238,659,517 (një miliard e dyqind e tridhjetë e tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

2. ALB- STAR

J62903512W

Vlera: 1,185,600,064.31 (një miliard e njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind mijë e gjashtëdhjetë e katër presje tridhjetë e një) Lekë pa TVSH.

## 3. ALBAVIA

J81527001Q

Vlera: 1,071,374,039.10 (një miliard e shtatëdhjetë e një milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e nëntë presje dhjetë) Lekë pa TVSH.

## 4. BOE "GJOKA KONSTRUKSION &amp; SELAMI"

J91815014U / J77304706L

Vlera: 1,199,360,489.60 (një miliard e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë presje gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH.

## 5. BOE "KUPA &amp; SIRETA 2F &amp; ARB &amp; TRANS-2010 &amp; ALKO-IMPEX General Constuction

K51615512C / K51501008J / L02325001T / K91326028I

Vlera: 1,211,407,469 (një miliard e dyqind e njëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatë mijë e katërqind e nëntë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. 2 T

K01731001M

2. ALBAVIA

J81527001Q

3. BOE "KUPA &amp; SIRETA 2F &amp; ARB &amp; TRANS-2010 &amp; ALKO-IMPEX General Constuction

K51615512C / K51501008J / L02325001T / K91326028I

Arsyet e skualifikimit si më poshtë:

I. OE "ALBAVIA" nuk kualifikohet pasi nuk permbush kerkesat per kualifikim te percaktuara ne dokumentat standard te tenderit.

- Nuk permbush kapacitetet teknike per disponimin e mjeteve dhe pajisjeve, pika 2.3.8.
- Nuk permbush kapacitetet teknike per disponimin e stafit kryesor dhe mbeshtetes, pika 2.3.5.
- Nuk permbush kapacitetet teknike per disponimin e drejtuesit teknik te punimeve, pika 2.3.7 - Faza: Vleresim Teknik

II. OE "2T" nuk kualifikohet pasi nuk permbush kerkesat per kualifikim te percaktuara ne dokumentat standard te tenderit.

- Nuk permbush kapacitetet teknike per disponimin e mjeteve dhe pajisjeve, pika 2.3.8. - Faza: Vleresim financiar.

III. BOE "KUPA & SIRETA 2F & ARB & TRANS-2010 & ALKO-IMPEX General Constuction nuk kualifikohet pasi nuk permbush kerkesat per kualifikim te percaktuara ne dokumentat standard te tenderit.

I.1 • Nuk permbush kapacitetet teknike per disponimin e mjeteve dhe pajisjeve, pika 2.3.8.

- Nuk permbush kapacitetet teknike per disponimin e drejtuesit teknik te punimeve, pika 2.3.7 - Faza: Kriter i pergjithshem

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE "GJOKA KONSTRUKSION & SELAMI" me adresë: Nr.6, Rruga Dora D'Istria, Tiranë 1001, me NUIS: J91815014U / J77304706L, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,199,360,489.60 Vlera: 1,199,360,489.60 (një miliard e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë

presje gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH. / totali i pikëve të marra sipas sistemit [246.90], është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Krugor Shqiptar, me adresë “Rruga Sami Frashëri Nr.33 Tiranë”, Tel 042234487 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

## **SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A**

- Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “ALBA KONSTRUKSION shpk” Nipt: J61812013R, Adresë: Tirane Tirane Kryqezimi i Rruges Liman Kaba me Prokop Mima, Rezenca Olimpik, Shkalla nr 3, Kati 2, “A.K.M shpk” Nipt: L22301501A Adresë: Durres RRASHBULL ARAPAJ Durres, Fshati Arapaj, “A.SH. Engineering shpk” Nipt: L31617003F Adresë: Tirane Tirane TIRANE Rruga "Grigor Gjirokastriti", ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12, Kati i Parë, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë.
- Procedura e prokurimit/lotit Procedurë E Hapur – Punë
- Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF- 68411-05-05-2023
- Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtim puse duplikant, rrethim dhe pastrim të puseve ekzistuese në zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale UK durrës”
- Fondi limit: 50,000,000 (Pesëdhjetë milion) Lek pa TVSH.
- Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës. Afati i punimeve 180 ditë sipas grafikut të punimeve nga data e lirim të sheshit .
- Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]



- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto   
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesi I mëposhtëm ka marrë pjesë në këtë procedurë me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

BOE AKM shpk	Nipt L22301501A
Alba Konstruksion shpk	Nipt J61812013R
A.SH. Engineering shpk	Nipt L31617003F

Me vlerë të ofruar:

- 49.200.000 ( Dyzet e nëntë milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH
- 59.040.000 ( Pesëdhjetë e nëntë milion e dyzetë mijë) Leke me TVSH.

Operator ekonomik të skualifikuar nuk ka .

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “ALBA KONSTRUKSION shpk” Nipt: J61812013R, Adresë: Tirane Tirane Kryqezimi i Rrugës Liman Kaba me Prokop Mima, Rezenca Olimpik, Shkalla nr 3, Kati 2, “A.K.M shpk” Nipt: L22301501A Adresë: Durres RRASHBULL ARAPAJ Durres, Fshati Arapaj, “A.SH. Engineering shpk” Nipt: L31617003F Adresë: Tirane Tirane TIRANE Rruga "Grigor Gjirokastriti", ish Fusha e Aviacionit, Ndërtesa 12, Kati i Parë, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 49.200.000 ( Dyzet e nëntë milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha M22031502M sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Procedura është me 1 operator ekonomik , për këtë arsye nuk priten afatet e ankimit.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

Drejtuar: "ASI-2A CO" sh.p.k. me NIPT K53002402C

Adresa: Fier Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, Punë

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-67350-04-27-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit",

Fondi Limit 26,510,323.94 (njëzetë e gjashtë milion e pesëqind e dhjetë mijë e treqind e njëzetë e tre pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për 2 (dy) vite 2023 dhe 2024, si më poshtë:

- Për vitin 2023, është 19,637,000 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH;

- Për vitin 2024, është 6,873,323.94 (gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë e tre pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 4 (katër) muaj nga data e njoftimit të fillimit të punimeve

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike datë 02.05.2023, nr.39

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "AIDA CONSTRUCTION" sh.p.k., me NUIS M03116403L, me vlerë të ofertës 17,534,375.25 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë pikë njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

2. BOE "FLED" sh.p.k. me NUIS K17621104C & "SHKELQIMI 07" sh.p.k, me NUIS K68121808W, me vlerë të ofertës 19,678,681.00 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH

3. "ASI-2A CO" sh.p.k. me NUIS K53002402C, me vlerë të ofertës 20,041,353.15 (njëzetë milion e dyzetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tre pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

4. "INA" sh.p.k. me NUIS J61814009W, me vlerë të ofertës 20,190,604.00 (njëzetë milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa TVSH

5. “EURONDERTIMI 2000” sh.p.k. me NUIS K02003001O, me vlerë të ofertës 20,439,992.50 (njëzetë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH
6. “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. me NUIS K66613407H, me vlerë të ofertës 21,211,447.00 (njëzetë e një milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH
7. “2 N” sh.p.k. me NUIS L31615017L, me vlerë të ofertës 21,456,047.00 (njëzetë e një milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH
8. “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” sh.p.k. me NUIS K81314023A, me vlerë të ofertës 21,765,012.38 (njëzetë e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dymbëdhjetë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH
9. “SIRETA 2F” sh.p.k. me NUIS K51501008J me vlerë të ofertës 21,997,164.00 (njëzetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH
10. BOE “O.B. KONSTRUKSION” sh.p.k. NUIS K93728201A & “ALBA KONSTRUKSION”sh.p.k. me NUIS J61812013R, me vlerë të ofertës 22,220,000.00 (njëzetë e dy milion e dyqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH
11. “DESARET COMPANY” sh.p.k. me NUIS K01816001J, me vlerë të ofertës 22,885,695.84 (njëzetë e dy milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH
12. “LIQENI VII” sh.p.k. me NUIS K01730502W, me vlerë të ofertës 23,070,889.80 (njëzetë e tre milion e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH
13. “SENKA” sh.p.k. me NUIS J94808405Q, me vlerë të ofertës 24,154,083.00 (njëzetë e katër milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH
14. “T&XH” sh.p.k. me NUIS L72121504I, me vlerë të ofertës 24,386,277.30 (njëzetë e katër milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH
15. “FUSHA” sh.p.k. me NUIS J61922018S, me vlerë të ofertës 25,714,725.75 (njëzetë e pesë milion e shtatëqind e katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH
16. “AD – STAR” sh.p.k. me NUIS J69102207W, me vlerë të ofertës 34,216,194.44 (tridhjetë e katër milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër pikë dyzetë e katër) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k. M03116403L

Arsyet e skualifikimit:

Operatorin Ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k., me NUIS M03116403L, është skualifikuar pasi nuk ka dorëzuar/deklaruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË

PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT dhe 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, sipas Shtojcës 7 të DST, si dhe ofertë anomalisht të ulët, konkretisht si mëposhtë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k. ka dorëzuar ofertë anomalisht të ulët.

Në përgjigje të ofertës anomalisht të ulët, ofertuesi “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k., me NUIS M03116403L, me vlerë të ofertës 17,534,375.25 lekë pa tvsh, ka argumentuar vlerën e ofertës anomalisht të ulët, duke dhënë shpjegime dhe analizat teknike të çmimeve për zërat e punimeve. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mori në shqyrtim kthimin e përgjigjes, duke argumentuar si më poshtë:

- Faturat e paraqitura nga OE për argumentimin e çmimeve të materialeve elektrike, tubave dhe hidroizoluesve, nuk janë përkatësisht nga subjektet përkatëse nga të cilët ka paqaritur autorizim prodhuesi/distributori, por nga subjekte të tjera që operojnë në treg dhe rrjedhimisht nuk garanton AK për cilësinë e materialeve që paraqiten në këto fatura dhe që do të përdoren për përmbushjen me cilësi të punimeve.

KVO analizoi disa nga zërat e preventivit bashkë me çmimet e paraqitura nga OE në ofertën ekonomike dhe për të cilat OE nuk ka bërë argumentimin/analizën e ofertës së tij, si vijon:

- Në zërin e punës An-2.268/a shkallë montazh mermeri ju i jeni referuar me çmimin 4000 lekë/m<sup>2</sup> për 16 m<sup>2</sup> dhe keni çmimin total 64000 lekë.

Duke e krahasuar me çmimin 6529 lekë/m<sup>2</sup> të zërit të punës, sipas Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre të miratuar me Vendimin Nr. 629, datë 15.7.2015, (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (i përditësuar), ju jeni ulur 38.7%.

- Po të marrim në shqyrtim zërin e punës an 2.267/a me titull shtresë pllaka gres porcelanat me çmimin e paraqitura nga OE 1720 lekë, ku në manual është llogaritur 2198 lekë/, ulja është prej 21.74%.

- Në zërin e punës An – 2.375/1, me titull F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham të cilat zënë një peshë të konsiderueshme të preventivit, çmimi i sjellë nga OE është 11500 lekë/m<sup>2</sup>.

Duke e krahasuar me çmimin 14993 lekë/m<sup>2</sup> të zërit të punës, sipas Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre të miratuar me Vendimin Nr. 629, datë 15.7.2015, (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (i përditësuar), ju jeni ulur me 23.3%.

- Në zërin e punës An – 2.a-122 F.V. Kanalinë metalike 210 x 65, me çmimin e sjellë nga ju 600 lekë/ml.

Duke e krahasuar me çmimin 2041 lekë/ml të zërit të punës, sipas Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre të miratuar me Vendimin Nr. 629, datë 15.7.2015, (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (i përditësuar), ju jeni ulur me 70.6%.

- Në zërin e punës An 2.495 F.V lavaman porcelani me mishelator, me çmimin e sjellë nga ju 9000 lekë copa.

Duke e krahasuar me çmimin 10613 lekë/copa të zërit të punës, sipas Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre të miratuar me Vendimin

Nr. 629, datë 15.7.2015, (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) (i përditësuar), ju jeni ulur 15.2%.

- Ndërkohë referuar shkresës “Sqarimi dhe argumentimi i ofertës anomalisht më e ulët” e sjellë nga operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k., KVO pas shqyrtimit të dokumentacionin të dorëzuar konstaton se: OE ka paraqitur zëra që nuk janë në preventivin e ofertës ekonomike sipas kërkesave të DST, konkretisht zërat e punimeve të specifikuara tek “Zbërthimi sipas analizës teknike të zërave të punimeve”, ku është cituar: “F.V konstruksione metalike të përbëra”, si dhe “Tavan me kartonxhes” të cilat nuk përputhen me preventivin e punimeve të paraqitur nga OE.

Për punimet e taraces (hidroizolimi, polisteroli, betoni, etj) të paraqitura në preventivin e ofertës ju nuk keni paraqitur kontratat tuaja të furnizimit të lidhura me furnizuesit përkatës për çmimin që ju keni paraqitur në analizat tuaja. Gjithashtu, për punimet e shtresave të pllakave të paraqitura në preventivin e ofertës, ju nuk keni paraqitur kontratat tuaja të furnizimit të lidhura për pllakat gres porcelanat, parket laminat, pllaka majolike etj, për të argumentuar këto zëra të cilët zënë një pjesë të konsiderueshme të vlerës totale të preventivit të ofertuar.

Nga ana tjetër, për zërat e preventivit 2.37/5a Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km, 2.268/a Shkallë montazhi mermeri, 2.297/a Tavan gipsi (OE ka paraqitur analizë për tavan me kartonxhes), Pajisje H/S (2.495, 2.501, An-15, zërat “**Sistemi i sinjalizimit të zjarrit**”, nuk janë të argumentuar dhe ju nuk keni sjellë një analizë teknike për argumentimin e këtyre zërave pjesë të preventivit.

Ndër të tjera, për kushtet specifike ku çmimet e materialeve janë rritur, dhe sidomos ato të përcaktuara në Aktin Normativ Nr. 10, datë 18.5.2022, hekurit, çimentos, bitumit, aluminit, bakrit dhe zinkut, dhe pikërisht materiale disa prej të cilave do të përdoren në punimet që përfshijnë zërat e preventivit “*Punime Suvatimi dhe Veshje*” dhe që janë përbërës kryesor të cilët ndikojnë në vlerën ekonomike të ofertuar, argumentet e sjella nga ju janë kryesisht për fuqinë punëtore dhe jo për materialet që do të përdoren duke reflektuar dhe ndryshimin/rritjen e çmimeve sipas përcaktimeve të Aktit Normativ.

Duke vlerësuar informacionin e dhënë dhe pas shqyrtimit të provave të paraqitura nga ofertuesi, KVO nuk krijon binden se oferta është e rregullt në të gjitha elementet e saj, pasi nuk janë marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 dhe 3, të nenit 93 të LPP-së, dhe rrjedhimisht konkludojmë se materiali i paraqitur - analiza e çmimeve, si dhe arsyetimet e sjella nga ana juaj për objektin e procedurës së prokurimit nuk merret parasysh, pasi nuk garantojnë AK për cilësinë dhe standartet e punimeve.

- Operatori ekonomik nuk përmbush Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 8, pasi Plani i organizimit të punimeve dhe Plani i sigurisë në kantier të paraqitur nga operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k., nuk është objekt i procedurës së prokurimit për MTM. Dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik për përmbushjen e këtij kriteri, i përkasin një procedurë të prokurimit të Bashkisë Tiranë dhe ka objekt tjetër prokurimi. Afati dhe kohëzgjatja e projektit nuk është 4 (katër) muaj siç dhe përcaktohet në DST dhe në njoftimin e kontratës për këtë procedurë, por në dokumentet e paraqitura nga OE përshkruhet se kohëzgjatja e projektit është 10 (dhjetë) muaj. Gjithashtu, aktivitetet dhe zërat e punimeve që përshkruhen të Plani i organizimit të

punimeve dhe Plani i sigurisë i paraqitur nga OE (si punime germimi, skarpata kanalesh, punime të transportit, trajtim dherash, etj) nuk janë në përputhje me punimet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK në DST për këtë procedurë.

- Operatori ekonomik nuk përmbush Kriteret të Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 9, pasi autorizimet e prodhuesit dhe distributorit për materialet elektrike dhe hidroizolues të paraqitura nga Operatori Ekonomik nuk kanë objekt procedurën e prokurimit të MTM, por i përkasin një objekti procedure tjetër, konkretisht:

OE ka paraqitur një Autorizim Distributori nga "ITE GRUP" sh.p.k. për materialet elektrike, i cili i referohet një procedurë të specifikuar për Bashkinë Tiranë.

Në lidhje me Autorizimin e Prodhuesit "DEUTCHCOLOR" sh.a., për hidroizoluesit, Autorizimi i paraqitur ka objekt "Shtrimi i rrugëve në fshatin Gurrë e vogël" dhe specifikohet për Bashkinë Tiranë.

Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", nenit 47, nenit 75, nenit 82, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe dokumentat e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është 66 dhe nuk pranohet, pasi në këtë fazë OE nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

2. BOE "FLED" sh.p.k. me NUIS K17621104C & "SHKELQIMI 07" sh.p.k, me NUIS K68121808W

Arsyet e skualifikimit:

BOE "FLED" sh.p.k. me NUIS K17621104C & "SHKELQIMI 07" sh.p.k, me NUIS K68121808W është skualifikuar pasi nuk ka dorëzuar/deklaruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT dhe 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, sipas Shtojcës 7 të DST, konkretisht: Kriteret të veçanta të kualifikimit, te Pika 1, Ofertuesi duhet të paraqesë, germa d), te Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 5, pika 9 dhe pika 11, konkretisht si mëposhtë:

- Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca 8, Pjesa II/A Deklaratë për Përmbushjen e Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit, Operatori Ekonomik "SHKELQIMI 07" sh.p.k., nuk është vendosur në fushat e përcaktuara adresa përkatëse ku gjënden baza e të dhënave për subjektin sipas përcaktimeve të nenit 26, pika 3 e VKM 285/2021 ku citojmë: "Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash".
- BOE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, nuk ka dëshmuar apo deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Deklarata B, për punonjësit teknik ndërtimi, teknik mekanik punonjës karpentier, numrin dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin e diplomës/certifikatës profesionale sipas kërkesave të DST. Gjithashtu, për punonjësit automakinistë nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Deklarata B, numrin dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise së dëshmise së aftësisë profesionale sipas përcaktimeve në DST, në mënyrë që AK të kryejë verifikimet përkatëse.
- BOE nuk përmbush pikën 2.3 të kapacitetit teknik, pika 9, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim /kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi



/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- ✓ Materiale elektrike
- ✓ Tuba
- ✓ Hidroizolues

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për rastin konkret, operatori ka paraqitur një Autorizim për materiale elektrike, tuba dhe hidroizolues nga shoqëria “Frutibest” shpk nën cilësinë e distributorit për këto materiale, por nuk ka paraqitur dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

- BOE nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, nuk ka dëshmuar të ketë të gjitha mjetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, BOE nuk ka deklaruar që të ketë në pronësi ose me qera Autovinç me kosh për punime në lartësi.

Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 47, nenit 75, nenit 82, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentat e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është e **skualifikuar** dhe nuk pranohet, pasi në këtë fazë BOE nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

3. “INA” sh.p.k.

J61814009W

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “INA” sh.p.k. me NUIS J61814009W, është skualifikuar pasi nuk ka dorëzuar/deklaruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT dhe 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, sipas Shtojcës 7 të DST, konkretisht: Kriteria të veçanta të kualifikimit, te Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 9, konkretisht si mëposhtë:

- OE nuk përmbush pikën 2.3 të kapacitetit teknik, pika 9, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, për këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- ✓ Materiale elektrike

Në rastet kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për rastin konkret, operatori ekonomik ka paraqitur Autorizim për materiale elektrike nga shoqëria “ABIESSE” shpk nën cilësinë e distributorit për këto materiale, por nuk ka paraqitur dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 47, nenit 75, nenit 82, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentat e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është e skualifikuar

dhe nuk pranohet, pasi në këtë fazë BOE nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

4. “SIRETA 2F” sh.p.k.

K51501008J

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “SIRETA 2F” sh.p.k. me NUIS K51501008J, është skualifikuar pasi nuk ka dorëzuar/deklaruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT dhe 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, sipas Shtojcës 7 të DST, konkretisht: Kriteret të veçanta të kualifikimit, te Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 4, konkretisht si mëposhtë:

- Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit OE nuk ka deklaruar stafin inxhinierik sipas kërkesave të DST, konkretisht mungon 1 (një) Inxhinier Gjeodet. Referuar pikës 4/b të nenit 41 të VKM-së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, përcaktohet se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:[...] b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj...”*. OE ndër të tjera ka deklaruar një Inxhinier Gjeolog.

Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 47, nenit 75, nenit 82, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentat e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është e skualifikuar dhe nuk pranohet, pasi në këtë fazë BOE nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

5. “T&XH” sh.p.k.

L72121504I

Arsyet e skualifikimit:

Operatorin ekonomik “T&XH” sh.p.k. me NUIS L72121504I, është skualifikuar pasi nuk ka dorëzuar/deklaruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT dhe 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, sipas Shtojcës 7 të DST, konkretisht: Kriteret të veçanta të kualifikimit, te Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 9, konkretisht si mëposhtë:

- OE nuk përmbush pikën 2.3 të kapacitetit teknik, pika 9, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, për këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- ✓ Materiale elektrike
- ✓ Tuba
- ✓ Hidrozolues

OE ka dorëzuar autorizimet e firmsve prodhuese të materialeve elektrike, tuba dhe hidrozolues me distributorët përkatës, por nuk ka paraqitur një Autorizim nga distributori apo kontratë që autorizon operatorin ekonomik “T&XH” sh.p.k. për furnizimin me këto materiale pranë tyre.

Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 47, nenit 75, nenit 82, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të



ndryshuar, si dhe dokumentat e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është e **skualifikuar** dhe nuk pranohet, pasi në këtë fazë OE nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

6. “FUSHA” sh.p.k.

J61922018S

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “FUSHA” sh.p.k. me NUIS J61922018S, është skualifikuar pasi ka dorëzuar/deklaruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e të gjithë 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT dhe 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, sipas Shtojcës 7 të DST, konkretisht: Kriteria të veçanta të kualifikimit, te Pika 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 9, konkretisht si mëposhtë:

- OE nuk përmbush pikën 2.3 të kapacitetit teknik, pika 9, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, për këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- ✓ Materiale elektrike
- ✓ Hidroizolues

Në rastet kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për rastin konkret, operatori ekonomik ka paraqitur Autorizim/kontratë për materiale elektrike nga shoqëria “SIAME” shpk nën cilësinë e distributorit për këto materiale, por nuk ka paraqitur dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

Gjithashtu, OE ka paraqitur Autorizim/Kontratë për hidroizolues nga shoqëria “IZOGRUP” shpk nën cilësinë e tregtuesit për këto materiale, por nuk ka paraqitur dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 47, nenit 75, nenit 82, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentat e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është e skualifikuar dhe nuk pranohet, pasi në këtë fazë BOE nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

7. “AD – STAR” sh.p.k.

J69102207W

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “AD – STAR” sh.p.k., me NUIS J69102207W, është skualifikuar pasi ka dorëzuar ofertë ekonomike mbi fondin limit të përlogaritur për këtë procedurë.

Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 47, nenit 75, nenit 82, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentat e tenderit të miratuara, Komisioni vendosi se oferta është e skualifikuar dhe nuk pranohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ASI-2A CO” sh.p.k. me NIPT K53002402C dhe adresë: Fier, Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6, se oferta e paraqitur me vlerë të prgjithshme prej 20,041,353.15 (njëzetë milion e dyzetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tre pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor Ministria e Turizmit dhe Mjedisit sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 20,439,992.50 (njëzetë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

## **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT** **RRUGOR TIRANË**

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë:

- “ARKONSTUDIO” shpk, me NIPT L42019004I ; Adresa: Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33, Tiranë.
- “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk, me NIPT K91628013D ; Adresa : Rruga Reshit Petrela, Kompleksi Usluga, kati i 8, pranë stacionit të trenit, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur, elektronike –Punë - mbi kufirin e ulët dhe nën kufirin e lartë monetar”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [“Rikonstruksion i QKT dhe godina administrative për DRSHTRR Kukës”, me REF-63884-03-28-2023, kohëzgjatja e kontratës 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e fillimit të punimeve]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “ARKONSTUDIO” shpk me NIPT L42019004I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk me NIPT K91628013D;

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera 69.920.345 ( gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e njëzetë mijë e treqind e dyzetë e pesë ) lekë pa TVSH ( e shprehur në shifra dhe fjalë)

– Në total vlerësimi me pikë për BOE “ARKONSTUDIO” shpk & “ALKO-IMPEX General Construction” shpk është vlerësuar nga të tre anëtarët e KVO-së sipas sistemit me 197.10 pikë.

2. BOE “2 N” shpk me NIPT L31615017L & “Jody-Kompany” shpk me NIPT J94824803M;

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 73.601.699 ( shtatëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë ) lekë pa TVSH ( e shprehur në shifra dhe fjalë)
- Nuk plotëson kërkesën e pikës 2.2.5/2, të kriterëve të veçanta për kualifikim të DT, pasi vlera e ofertës ekonomike e paraqitur nga ofertuesi është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.  
KVO, bazuar në VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe referuar rekomandimit të APP-së nr. 5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, vendosi të refuzojë ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” sh.p.k., pasi rezulton nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

**4. Operatori ekonomik “TOWER” sh.p.k., me NUIS L21717003H.**

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “TOWER” sh.p.k., me NUIS L21717003H, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim dhe konkretisht:

- Nuk plotëson kërkesën e pikës 2.2.5/2, të kriterëve të veçanta për kualifikim të DT, pasi vlera e ofertës ekonomike e paraqitur nga ofertuesi është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.  
KVO, bazuar në VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe referuar rekomandimit të APP-së nr. 5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, vendosi të refuzojë ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “TOWER” sh.p.k., pasi rezulton nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

\* \* \*

Në zbatim të pikës 6, të nenit 82, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, fituesi paraprak i procedurës së prokurimit me objekt “Mbikëqyrje e punimeve për kontratën/projektin me objekt “Ndërtim hangari për helikopterë, në Bazën Ajrore Farkë””, u përcaktua me shortin e datës 24.05.2023, pasi 2 (dy) nga operatorët ekonomikë të kualifikuar, kishin paraqitur ofertë ekonomike me të njëjtin çmim më të ulët, konkretisht vlera ishte 3,701,826.51 (tre milionë e shtatëqind e një mijë e tetëqind e njëzet e



gjashtë pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Nga shorti i hedhur rezultoi ofertues i kualifikuar i pari, operatori ekonomik “ARENA MK” sh.p.k., me NUIS L67619801Q.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ARENA MK” sh.p.k., me NUIS L67619801Q dhe adresë: “Fier, Ballsh, Dukas, Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndërtesa private nr.2, Zona kadastrale 1566, nr. pasurie 93/14. 9333”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,701,826.51 (tre milionë e shtatëqind e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë Rruga e Dibrës, Tiranë] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të zbatohen parashikimet e nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):

PO  JO

## **SH.A KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE TIRANE**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “GJEOKONSULT & CO” sh.p.k, NIPT K91810005U, me adresë Njësia Administrative Nr.05, Rruga Sami Frashëri, Pallati Nr.45, Shkalla 01, Kati i parë, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - shërbim konsulence.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR.REF -58934-02-14-2023.

Numri i referencës Loti I: NR.REF- 58940-02-14-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Batimetria e liqeneve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”, e ndarë në LOTE.

LOTI I: “Batimetria e liqenit Fierzë, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”.

Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.17, datë 20/02/2023.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

✚ Operatori Ekonomik “GJEOKONSULT & CO” sh.p.k, NIPT K91810005U, me adresë Njësia Administrative Nr.05, Rruga Sami Frashëri, Pallati Nr.45, Shkalla 01, Kati i parë, Tiranë.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

✚ Operatori Ekonomik “GJEOKONSULT & CO” sh.p.k, NIPT K91810005U, me vlerë 104,800,000 (Njëqind e katër milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra sipas sistemit [178.40] pikë.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

Nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “GJEOKONSULT & CO” sh.p.k, NIPT K91810005U, me adresë Njësia Administrative Nr.05, Rruga Sami Frashëri, Pallati Nr.45, Shkalla 01, Kati i parë, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 104,800,000 (Njëqind e katër milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH, totali i pikëve të marra sipas sistemit [178.40] pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Përsa i përket afateve të ankimit, referuar nenit 96 pika 2 gërma (a) të Ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet se “Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues”, për procedurën e sipërcituar, duke qenë se ka pasur vetëm një ofertues të kualifikuar dhe të shpallur fitues, nuk aplikohet periudha e pritjes.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

## **ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY SH.A**

Për: OE “CLASS ASHENSOR” SHPK

Adresa: Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite, Tiranë

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur e thjeshtuar me marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara,

me objekt “Shërbim për mirëmbajtjen e ashensorit me

fond limit: 3,560,453 (tre milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa tvsh dhe afat 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-69400-05-16-2023;

Publikime të mëparshme: Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 45, datë 22 Maj 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju bëjmë me dije se, në këtë procedurë ka marrë pjesë ofertuesi me vlerën përkatëse si më poshtë:

1.OE “CLASS ASHENSOR” shpk– NUIS L01325010Q

Vlerë oferte 3,101,500 (tre milion e njëqind e një mijë e pesëqind) lekë pa tvsh;

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë të mëposhtëm: Nuk ka OE të skualifikuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë OE “CLASS ASHENSOR” shpk me adresë: Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej 3,101,500 (tre milion e njëqind e një mijë e pesëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek “Albanian Gas Services Company” SHA me adresë: Njesia Administrative Nr.5, Rruga e Kosovarëve, Pallati NdërPro, Kati 1, Tiranë, brenda 60 (gjashtëdhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Bazuar në shkronjën b), të pikës 2, të nenit 96 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, periudha e pritjes nuk do të zbatohet.

---

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

Drejtuar: "HTM" SHPK, me adresë: Lagjja Perash, Rruga Rrojev, Nr 44, Shkodër.

Procedura e prokurimit/lotit: "E hapur - mbi kufirin e lartë monetar".

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-64946-04-05-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Mirëmbajtja e aseteve elektronergjitike (3 vite)".

Kohëzgjatja e kontratës: 36 (tridhjetë gjashtë) muaj.

Buletini i Njoftimeve Publike: 11.04.2023, Nr. 32.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- "HTM" SHPK, me NUIS K97006004D;  
Oferta, në vlerën 85.348.800 (tetëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë, pa TVSH.
- "KUPA" SHPK, me NUIS K51615512C;  
Oferta, në vlerën 86.654.640 (tetëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë, pa TVSH.
- "SENKA" SHPK, me NUIS J94808405Q;  
Oferta, në vlerën 87.105.900 (tetëdhjetë e shtatë milion e njëqind e pesë mijë e nëntëqind) lekë, pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- "KUPA" SHPK, me NUIS K51615512C, për arsyet e mëposhtme:
  1. Formulari i vetëdeklarimit ka të deklaruar më pak mjete dhe staf të kualifikuar nga sa kërkohen në DT;
  2. Mungojnë dokumenta që do të vertetonin se kualifikimet profesionale të tij janë të plota dhe cilesisht në përputhje me llojet dhe specifikat e sistemeve elektrike dhe elektroenergjitike të instaluar në APD dhe që do të mirembahen e riparohen prej tij. Për këtë, ai duhet të prezantojë dokumenta si: licenca, autorizime/marveshje partneriteti dhe certifikata specializimi, të leshuara operatorit ekonomik ofertues/ose personelit të tij, nga prodhuesit kryesorë të sistemeve të instaluar;
  3. Për inxhinierët dhe stafin nga pika 2.3.10 deri në 2.3.14 - nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar;

4. Nuk është paraqitur Plani operacional i detajuar per zbatimin e kesaj Kontrate duke perfshire metodologjine, burimet njerezore, makinerite dhe pajisjet dhe sistemin koordinimit dhe menaxhimit sipas pikës 2.3.27
  5. Nuk është paraqitur Plani paraprak i mirembajtjes se aseteve dhe instalimeve energjitike - SHTOJCA\_J - LISTA E SISTEMEVE DHE PAJISJEVE - sipas pikës 2.3.28.
- “SENKA” SHPK, me NUIS J94808405Q, për arsytet e mëposhtme:
    1. Formulari i vetëdeklarimit ka të deklaruara më pak mjete dhe staf të kualifikuar nga sa kërkohen në DT;
    2. Mungojnë dokumenta qe do te vertetonin se kualifikimet profesionale te tij jane te plota dhe cilesisht ne perputhje me llojet dhe specifikat e sistemeve elektrike dhe elektroenergjitike te instaluar ne APD dhe qe do te mirembahen e riparohen prej tij. Per kete, ai duhet te prezantoje dokumenta si: licenca, autorizime/marreveshje partneriteti dhe certifikata specializimi, te leshuara operatorit ekonomik ofertues/ose personelit te tij, nga prodhuesit kryesore te sistemeve te instaluar;
    3. Për inxhinierët dhe stafin nga pika 2.3.10 deri në 2.3.14 - nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar;
    4. Nuk është paraqitur Plani operacional i detajuar per zbatimin e kesaj Kontrate duke perfshire metodologjine, burimet njerezore, makinerite dhe pajisjet dhe sistemin koordinimit dhe menaxhimit sipas pikës 2.3.27.
    5. Nuk është paraqitur Plani paraprak i mirembajtjes se aseteve dhe instalimeve energjitike - SHTOJCA\_J - LISTA E SISTEMEVE DHE PAJISJEVE - sipas pikës 2.3.28.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë HTM” SHPK, me adresë: Lagjja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44, Shkodër, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 85.348.800 (tetëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind) lekë, pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Portual Durrës, me adresë: Lagjja Nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

## **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TË SHETIT**

Drejtuar: “ARENA MK ” SH.P.K me adresë rruga “ Nacionale Ballsh-Fier, ndërtesa private Nr. 2.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar, shërbim.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-68770-05-09-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 2 Mbikqyrje e punimeve në objektin “Rikonstruksion i ambjentëve të jashtme dhe ndërtimi i Amfiteatrit në DPA”, me Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 1 (një) vit.

Fondi limit për lotin 2: 375.689 (treqinde e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [15.05.2023] [Nr. 43] dhe [5.6.2023] [Nr. 51]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. A.SH.Enginiering shpk

L31617003F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 396 727,58 (treqindë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH

2. ARENA MK shpk

L67619801Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 324 107 (treqindë e njëzet e katër mijë e njëqind e shtatë) lekë pa TVSH.

3. BOE DAAM &NET GROUP shpk

L72205042F L72023002P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 324 106,55 (treqindë e njëzet e katër mijë e njëqind e gjashtë pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

4. G B Civil Engineering shpk L51825011V  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 324 107 (treqindë e njëzet e katër mijë e njëqindë e shtatë) lekë pa TVSH.

5. HYDRO-ENG CONSULTING shpk M11417503F  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 302 974,63 (treqindë e dy mijë e nëntëqindë e shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

6. BOE M.A.K Studio& GREEN EAGLE CONSULTING shpk L01422017O L81603023A  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 329 584,12 (treqindë e njëzet e nëntë mijë e pesëqindë e tetëdhjetë e katër pikë dymbëdhjetë ) lekë pa TVSH.

7. MAGNA CHARTA shpk L92318021H  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 324 106,55 (treqindë e njëzet e katër mijë e njëqindë e gjashtë pikë pesëdhjetë e pesë ) lekë pa TVSH.

8. SPHAERA shpk J81809003U  
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it  
Vlera 324 251 (treqindë e njëzet e katër mijë e dyqindë e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "HYDRO – ENG CONSULTING" shpk NIPT M11417503F.  
Oferta ekonomike e dorëzuar nga Operatori ekonomik "HYDRO – ENG CONSULTING" shpk me vlerë 302 974,63 lekë është nën vlerën minimale të përlloritur nga AK, referuar kriterëve të kualifikimit në DST konkretisht:

"Shënim: Kandidati ofertues në për llogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrj edhe kolaudim".

2. Operatori Ekonomik "MAGNA CHARTA" shpk NIPT L92318021HO.  
Oferta ekonomike e dorëzuar nga operatori ekonomik "MAGNA CHARTA" shpk me vlerë 324 106,55 lekë është nën vlerën minimale të përlloritur nga AK, referuar kriterëve të kualifikimit në DST konkretisht:

"Shënim: Kandidati ofertues në për llogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrj edhe kolaudim".



3. Bashkimi i Operatorëve “DAAM” shpk & “NET GROUP” shpk me NIPT L72205042F dhe NIPT L72023002P.

Oferta ekonomike e dorëzuar nga BOE “DAAM” shpk & “NET GROUP” shpk me vlerë 324 106,55 lekë është nën vlerën minimale të përlogaritur nga AK, referuar kriterëve të kualifikimit në DST konkretisht:

“Shënim: Kandidati ofertues në për llogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”.

4. Bashkimi i Operatorëve “M.A.K Studio” shpk, NIPT L014220170 dhe “GREEN EAGLE CONSULTING” shpk, NIPT L81603023A .

Referuar Dokumenteve Standarde të Tenderit, në pikën 2.14.1 parashikohet si më poshtë:

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

një Lot,

disa Lote,

T të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

BOE “M.A.K Studio & GREEN EAGLE CONSULTING”, ka ofertuar në 4 Lotet e kësaj procedure dhe nga verifikimi i Formularit të Vetëdeklarimit rezultoi se kanë deklaruar “staf inxhinierik” të njëjtë në cdo Lot, duke mosplotësuar kriterin e lartpërmendur.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “ARENA MK ” SHPK me adresë: Rruga Nationale Ballsh-Fier, ndërtesa private Nr. 2, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 324 107 (treqindë e njëzet e katër mijë e njëqind e shtatë) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me adresë Rruga “Jordan Misja” 8303, Tiranë me nr. 35544541798/35544541793 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [324.107 lekë pa tvsh], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_



Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

### **BASHKIA KOLONJË**

Drejtuar: B.O.E “ETTA CONS” shpk me Nius M22314016O & “ARABEL – STUDIO” shpk me Nius L51812001S & ”JOKLEN & CO” shpk me Nius K84322601F  
Adresa:ETTA CONS shpk Tirane Lagjia "Unaza e Re", Njësia 14,Rruga "Mילו Sotir Gura", zona kadastrale 3866, Nr. Pasurie, 306/370-1-5,ARABEL – STUDIO shpk, Diber Peshkopi PESHKOPI Lagjia “Gjoke Doçi”, Bulevardi “Elez Isufi”, Z.K.Nr.2932, Zyra në Ndërtesën Nr.05, JOKLEN & CO shpk, Korce Pogradec POGRADEC Rruga Qani Çollaku, lagj nr 2, pallati nr 3,nr pasurie N4/221, zona kadastrale nr 3851.

Procedura e prokurimit/lotit: Proçedurë e hapur e thjeshtuar,Shërbime.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-60602-02-27-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Hartimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Bashkia Kolonjë (EKONOMIA PYJORE Qëndër Novosele),viti 2023, dhe

kohëzgjatja e kontratës fillon nga nënshkrimi i kontratës me përfundim në 3 (tre) muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 34 datë 18 Prill 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. B.O.E	ETTA CONS shpk	ARABEL – STUDIO shpk	JOKLEN & CO shpk
	M22314016O	L51812001S	K84322601F
Emri i plotë i shoqërisë	Numri i NIPT-t		

Vlera 5,774,650 (Pesëmilioneshtatëqindeshtatëdhjetëekatërmijëegjashtëqindepesëdhjetë) lekë pa Tvsh.  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. B.O.E LORENCO & CO shpk           Gjelbërimi 2000 shpk  
          J61903071B                        L21513012D

Emri i plotë i shoqërisë   Numri i NIPT-t

Vlera 5,201,585 (Pesëmilionedyqindenjëmijëepesëqindetëdhjetëepesë) lekë pa Tvsh.  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. O.E LURIMI shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

J68403912U  
Numri i NIPT-it

Vlera 4,355,425 (Katërmilioneqindeshtatëepesëmijëekatërqinde njëzetë epesë) lekë pa Tvsh.  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)  
Etj. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Oferta e paraqitur nga B.O.E “LORENCO & CO” shpk me Nius J61903071B & “Gjelbërimi 2000” shpk me Nius L21513012D

a. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1, gërma a, kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomik “B.O.E “LORENCO & CO” shpk & “Gjelbërimi 2000” shpk, është konstatuar se është paraqitur formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9, nga të dy operatorët e këtij bashkimi, por referuar pikës 1 dhe 2 gërma (c) të nenit 26, të VKM-se nr.285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla,

2. formulari përmbledhës i vetdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka plotësuar të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit në Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit kreu A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në seksionin në lidhje me informacionin dhe deklarin në zbatim të pikës 2 gërma (c) të nenit 26, të VKM-se

nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën duhet të deklarohet si më poshtë:

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; Sa më sipër duke qenë se bashkimi i operatorëve ekonomik “B.O.E “LORENCO & CO” shpk & “Gjelbërimi 2000” shpk, nuk ka deklaruar në shtojcën 9 emrat e personit/ave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

b.Në kriteret e veçanta të kualifikimit,pika 2.3.4, Kapaciteti Teknik , kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në Pronësi ose me Qira:

Gps për matje topografike	copë
1	
Hipsometer sunnto	copë
1	
Diametermates	copë
1	
Metershirit	copë
1	
Tryel pressler	copë
1	

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomik “B.O.E “LORENCO & CO” shpk & “Gjelbërimi 2000” shpk, është konstatuar se është paraqitur formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, nga të dy operatorët e këtij bashkimi,si dhe marrëveshja e bashkëpunimit e hartuar ndërmjet palëve me datë.09.03.2023 ku kanë përcaktuar pjesën e shërbimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi konkretisht: LORENCO & CO shpk,ka marrë përsipër të realizojë 70%, ndërsa Gjelbërimi 2000 shpk,ka marrë përsipër të realizojë 30%.

Referuar pikës 1 dhe 2 gërma (i) të nenit 26, të VKM-së nr.285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se:

1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPPsë, dhe në këto rregulla,

2. formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik rezulton se antari i bashkimit të operatorëve ekonomik Gjellbërimi 2000 shpk nuk ka deklaruar të dhënat për mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor pika 2.3.4, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit kreu B: Deklaratë,Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshmenë seksionin në lidhje me informacionin dhe deklarimin në zbatim të pikës 2 gërma (i) të nenit 26,të VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën duhet të deklarohet si më poshtë:

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të hartuar ndërmjet palëve me datë.09.03.2023 ku kanë përcaktuar pjesën e shërbimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi konkretisht: LORENCO & CO shpk,ka marrë përsipër të realizojë 70%, ndërsa Gjellbërimi 2000 shpk,ka marrë përsipër të realizojë 30%, dhe për këtë objekt fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar nga secila palë janë përcaktuar si mëposhtë :

Nr.	Aktiviteti	LORENCO & CO shpk	Gjellbërimi 2000 shpk
1	Punime përgatitore	x	x
2	Punimet e terrenit	x	x
3	Punimet e zyrës	x	x
4	Përgatitja Draft Planit	x	x
5	Dorëzimi i Draft Planit të Mbarështimit	x	x
6	Raportimi përfundimtar	x	x
7	Diskutim me aktorët e fushës dhe mbrojtja e Draft Planit	x	x
8	Dorëzimi i Planit të ri të Mbarështimit	x	x

Referuar pikës 3 të nenit 88, të VKM-së nr.285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se:

3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për të përmbushur këtë kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së, te dhënat për mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës sipas përcaktimeve të mësipërme dhe anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik Gjellbërimi 2000 shpk nuk ka deklaruar të dhënat për mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor pika 2.3.4, por ka deklaruar (kamion, vinç,makina mjetedore etj), mjete të cila nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Për faktin se ky anëtar ka marrë përsipër të realizojë për këtë objekt të gjitha fushat/ekspertizat duhet të përmbushë këtë kërkesë për kualifikim në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim referuar pikës 2 gërma (i) të nenit 26 dhe pikës 3 të nenit 88, të VKM-se nr.285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa më sipër duke qënë se antari i bashkimit të operatorëve ekonomik Gjëlberimi 2000 shpk, nuk ka deklaruar të dhënat për mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor pika 2.3.4 , ky kriter konsiderohet i papërmbushur. Bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomik LORENCO&CO shpk dhe Gjëlberimi 2000 shpk për mos përmbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese. Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, bashkimi i operatorëve ekonomik LORENCO & CO shpk dhe Gjëlberimi 2000 shpk, s’kualifikohet.

2.Oferta e paraqitur nga O.E “LURIMI” shpk me Nius J68403912U

a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit,pika 1,gërma b, kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Në seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike,pika 3.2 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit,autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik rezulton se operatori ekonomik LURIMI shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar Policën e Sigurimit të Ofertës me numër serial 0009378 lëshuar më 13.03.2023 në të cilin parashikohet se: Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën 13.03.2023 deri në 90 ditë.

Në nenin Neni 83 të ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”,parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor.

Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

- i. në formën e garancisë bankare; ose
  - ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.
3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:
- a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;
  - b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.
  - c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.
4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit e ofertës, nëse:
- a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;
  - b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit;
  - c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.
5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.
6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Sa më sipër duke qënë se operatori ekonomik LURIMI shpk, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas kërkesës së autoritetit kontraktor kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1, gërma b, ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Pra afati i vlefshmërisë për sigurimin e ofertës është 90 ditë, ku në DST është kërkuar 150 ditë.

Bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik LURIMI shpk për mos përmbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik LURIMI shpk, s’kualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë B.O.E “ETTA CONS” shpk me Nius M22314016O & “ARABEL – STUDIO” shpk me Nius L51812001S & ”JOKLEN & CO” shpk me Nius K84322601F se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 5,774,650 (Pesëmilioneshatëqindeshatëdhjetë katërmijëegjashtëqindpesëdhjetë) lekë pa Tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë  
Emri Bashkisë Kolonjë  
Adresa Sheshi “ Rilindja ”



Tel/Fax +355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173

E-mail bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi , por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Vendim i komisionit të prokurimit publik nr.474/2023 me nr.852/5 prot,datë.06.06.2023.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës: Nuk është aplikuar

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

## **NDËRMARRJA E PASURIVE PUBLIKE LUSHNJE**

Drejtuar: “BIBA-X” sh.p.k me Adresë: Tirane, Lekaj, HARIZAJ, Fshati Kryeluzaj, , Pika Inerte 50m prane Karburant "EURODRIN".

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-69817-05-19-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Marrje mjetesh me qera (asfaltoshtruese,rrul etj)”

Fondi limit: 4,112,526(katër milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzetë e gjashtë) LEKË PA TVSH .

Kohëzgjatja e kontratës: nga data e nënshkrimit të kontratës deri me 31/12/2023.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Data 12/06/2023 Nr.53

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në  kosto
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “SARK” sh.p.k K52531415H  
Vlera: 3,839,715 (tre milionë e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) LEKË PA TVSH.

2. “BIBA-X” sh.p.k K32618815N  
Vlera: 4,097,532 (katër milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) LEKË PA TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE- “SARK” sh.p.k me Adresë: FIER Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier, Rajoni nr 3, Perball supermarket Lalaj, skualifikohet me 3(tre) vota PRO për arsye se nuk plotëson kriterin sipas pikes 2.3.2 të seksionit “Kapaciteti Teknik” ku përcaktohet se: “Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit, foto përkatëse ballore dhe anesore”.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas këtij kriteri për zërin Nr 4 të Preventivit gjithashtu as nuk e ka deklaruar si mjet në Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “BIBA-X” sh.p.k me Adresë: Tirane, Lekaj, HARIZAJ, Fshati Kryeluzaj, , Pika Inerte 50m prane Karburant "EURODRIN", se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4,097,532 (katër milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) LEKË PA TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ndërmarrjes së Pasurisë Publike, Lagjja “Gafurr Muco”, Lushnje, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pese)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.



Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

### **ECO-ELB sh.a**

Drejtuar: “ERGI” sh.p.k. me NIPT K02727229P dhe adresë Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurise 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjja 28 Nentori, Rajoni nr.3, Elbasan.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur - Prokurim me mjete Elektronike –Shërbim”

Numri i procedurës / referenca e Lotit:

REFI-68773-05-09-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës “Testim i Kaldajës dhe Turbinës”

me fond limit: Vlera e pritshme e kontratës që mund të lidhet gjatë Marrëveshjes kuadër: 2,273,600 (dymilion e dyqind e shtatëdhjetë e tremijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “ERGI” sh.p.k. me NIPT K02727229P

Vlera e ofruar: 2,267.600 (dymilion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

**2. Nuk ka**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si oferta e suksesshme:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| <b>1. “ERGI” sh.p.k. me</b>     | <b>NIPT K02727229P</b> |
| <b>Emri i plotë i shoqërisë</b> | <b>Numri i NIPT-it</b> |

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 2,267.600 (dymilion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin “ERGI” sh.p.k., me adrese: Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurisë 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagja 28 Nentori, Rajoni nr.3, Elbasan., se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2,267.600 (dymilion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor, “ECO - ELB” sh.a me adresë: Lagja “17 Brigada Sulmuese”, Rruga “11 Nentori”, Elbasan, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

**BASHKIA TIRANË**

Drejtuar: Bashkimit të operatorëve ekonomikë “A.SH. Engineering” shpk & ERSI/M shpk.

Adresa: Rruga “Grigor Gjirokastriti”, Ndertesa 12, Kati i Pare, Njesia Administrative Nr.7, Tirane.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Loti I: “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Sharrë”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF- 68334-05-04-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Sharrë”.

Fondi limit: 287,207.1 (dyqind e tetëdhjete e shtatë mijë e dyqind e shtatë pikë një) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2023, miratuar me VKB Nr.126, datë 23.12.2022, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023” si dhe VKB Nr.23, datë 17.03.2023, për disa ndryshime në VKB Nr.126, datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023”.

Kohëzgjatja e kontratës: 15 (pesëmbëdhjetë) javë kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 15.05.2023 , ora 10:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.41 datë 08.05.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori ekonomik “MCE” shpk NUIS L72203065K  
Vlera e ofertës = 198,000 (njëqind e nëntëdhjete e tete mije ) lekë pa TVSH.

2.Operatori ekonomik “BN PROJECT” shpk NUIS L21305035S  
Vlera e ofertës = 200,000 (dyqind mijë ) lekë pa TVSH.

3.Operatori ekonomik “HYDRO-ENG CONSULTING” shpk NUIS M11417503F  
Vlera e ofertës = 228,713.44 (dyqind e njetetë e tetë mije e shtatëqind e trembedhjete pike dyzetë e kater ) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “A.SH. Engineering” shpk & ERSI/M shpk  
NUIS L31617003F & J98624803O  
Vlera e ofertës = 243,387.78 (dyqind e dyzetë e tre mije e treqind e tetëdhjetë e shtate pike shtatëdhjetë e tetë ) lekë pa TVSH.

5.Operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” shpk NUIS L01717030C

Vlera e ofertës = 243,397.7 (dyqind e dyzetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtate pikë shtatë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ZENIT&CO” shpk & “Fta Studio” shpk NUIS K61731002D&L72411026N

Vlera e ofertës = 245,119.99 (dyqind e dyzetë e pese mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë pike nëntëdhjetë e nënte) lekë pa TVSH.

7.Operatori ekonomik “S&L Studio” shpk NUIS L61606040D

Vlera e ofertës = 254,928 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzete e tete) lekë pa TVSH.

8.Bashkimi i operatorëve ekonomik “SPHAREA” shpk & “ARKIMADE” shpk NUIS J81809003U & L01906030A

Vlera e ofertës = 277,173.3 (dyqind e shtatëdhjetë e shtate mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pike tre) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtem:

- Operatori ekonomik “MCE” shpk NUIS L72203065K

- k) Adresës e subjektit,telefonin,e-mail dhe faks.
- l) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
- m) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces,detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
- n) Vërtetim për shlyerjen e taksave,tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2022 dhe për vitin e fundit 2023 (këstet e maturuara),duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
- o) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
8. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.
9. Sigurimi i ofertës  
Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës,  
Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së fondit limit.  
Llogaritja bëhet:Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%.
10. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:
- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet,( i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar,hartuar konform kërkesave të projektit)..... 20 pikë.
- b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen ..... 15 pikë.

- c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes.....25 pikë.
- d) Nivelin e punësimit në veprimtari.....5 pikë.
- e) Masën e qerasë për ha/vit .....35 pikë.

11.Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit brenda 7 (shtatë) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00, pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkuresit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.

12.Dokumentacioni do të dorëzohet në sekretarinë e Bashkisë Kolonjë deri më datë 29.06.2023, para orës 11:00.

**BASHKIA KOLONJË**  
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti: Bashkia Kolonjë

Adresa Sheshi “ Rilindja ”  
Tel/Fax +355 812 23173 ; 08122225 ; 2232  
E-mail bashkia.kolonje@gmail.com  
Faqja e Internetit <http://www.kolonja.gov.al>

2. Dhënie me qira të fondit pyjor dhe kullor në përdorim, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Kolonjë, LOTI NR.3, -RISHPALLJE sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr Lotit	Njësia Administrative	Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Objekti i veprimtarisë.	Sipërfaqja		Vlera dysheme e qirasë Lekë/vit/ha	Kohë zgjatja (Vite)
					Ha	Km		
3	Qendër Erseke Ekonomia Pyjore/Kullore Qendër Novoselë Pranë fshatit Selenicë	3284	357/1	Për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.	69.7 ha		176,000	10
<b>T O T A L I</b>								



3. Qëllimi i dhënies me qira të fondit pyjor dhe kullosor, me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Kolonjë, LOTI NR.3, -RISHPALLJE është dhënia në përdorim për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.
4. Konkurrimi do të zhvillohet më datë: 29.06.2023, ora 11:00, në Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kolonjë.
5. Çmimi dysHEME i qirasë, është  
Kullotë: 176,000 (Njëqindeshtatëdhjetëegjashtë mijë) lekë/ha në vit.
6. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë tej afatit 10 (dhjetë) vjet.
7. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
  - a) Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
  - b) Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë,
  - c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, (i cili përmban hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit);
  - d) Planbизнесin dhe investimet që do të bëhen;
  - e) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin makineritë dhe paisjet që zotëron;
  - f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
  - g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
  - h) Raportin e vlersimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar;
  - i) Çmimin e qerasë së ofruar për ha/vit;
  - j) Afati i qirasë.
  - k) Adresës e subjektit, telefonin, e-mail dhe faks.
  - l) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
  - m) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
  - n) Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2022 dhe për vitin e fundit 2023 (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
  - o) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
8. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa



e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.

9. Sigurimi i ofertës

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës, Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së fondit limit. Llogaritja bëhet: Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%.

10. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:

- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet,( i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar,hartuar konform kërkesave të projektit)..... 20 pikë.
- b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen ..... 15 pikë.
- c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes.....25 pikë.
- d) Nivelin e punësimit në veprimtari.....5 pikë.
- e) Masën e qerasë për ha/vit .....35 pikë.

11.Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit brenda 7 (shtatë) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00, pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkuresit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.

12.Dokumentacioni do të dorëzohet në sekretarinë e Bashkisë Kolonjë deri më datë 29.06.2023, para orës 11:00.

---

# PROCEDURA KONKURRUESE PËR LEJE MINERARE

# **NJOFTIME TË TJERA**

## **SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK – GJINEKOLOGJIK** **“MBRETËRESHA GERALDINË”** **Njoftim për vend të lirë pune**

Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, shpall 1 (nje) vend te lire pune ne pozicionin Inxhinier

- Kandidati duhet të plotësojë kushtet për pranim si vijon:
  1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në Fakultetin e Inxhinierise Ndertimit;
  2. Te kete eksperience pune mbi 5 vite ne profesion
  3. Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter, sidomos programin autocad.
  4. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
  5. Trajnimet, dëshmi te tjera, kualifikimet dhe eksperiencat në fusha të ngjashme me objektin e vendit të punës së shpallur, përbëjnë avantazh.
  6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
  7. Te jete i/e disponueshme te punoje ne çdo kohe dhe orar.
  
- Dokumentet e nevojshme për aplikim:
  - a. Jetëshkrimi i kandidatit ( CV) (e detyrueshme);
  - b. Fotokopje e kartës së identitetit;
  - c. Diploma Universitare dhe lista e notave. (e detyrueshme);
  - d. Çertifikate personale/familjare
  - e. Fotokopje e librezës së punës; (e detyrueshme);
  - f. Dëshmi të kualifikimeve; (nese ka)
  - g. Vertetim i gjendjes gjyqësore (e detyrueshme);
  - h. Vertetin gjykate/prokurorie(e detyrueshme);  
(Raporti mjeko – ligjor i tre muajve të fundi ( i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës)
  - i. Te kete reference nga punedhens te fushes. (e detyrueshme);

Mosplotësimi i kritereve të mësipërm si dhe mungesa e një prej dokumentave të detyrueshme, e skualifikon automatikisht kandidatin.

- Vlerësimi i kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për diplomën, përvojën në profesion, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën dhe për intervistën me gojë.

Si eksperiencë në profesion, e cila vlerësohet me max. 10 pikë, do të konsiderohet vetëm eksperiencia në pozicionin inxhinier zbatues.

Intervista me gojë do të fokusohet mbi njohuritë profesionale dhe eksperiencën në punë max 10 pike.

Komisioni i Vlerësimit, brenda 3 (tre) ditë pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe brenda 2 (dy) ditë njofton datën për intervistën me gojë.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës pranë Zyrës së Protokollit të Institucionit nga data 19.06.2023 deri në datën 30.06.2023.

## **SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK – GJINEKOLOGJIK**

### **“MBRETËRESHA GERALDINË”**

#### **Njoftim për vend të lirë pune**

Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, shpall 1 (nje) vend të lire pune në pozicionin Kordinator/Receptionist

- Kandidati duhet të plotësojë kushtet për pranim si vijon:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare;
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vite;
3. Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter;
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
5. Trajnimet, dëshmi të tjera, kualifikimet dhe eksperiencat në fusha të ngjashme me vendin të punës së shpallur, përbëjnë avantazh;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
7. Të jete i/e disponueshme të punoje në çdo kohë dhe orar;

- Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- a) Jetëshkrimi i kandidatit ( CV) (e detyrueshme);
- b) Fotokopje e kartës së identitetit;
- c) Diploma Universitare dhe lista e notave. (e detyrueshme);
- d) Çertifikate personale/familjare
- e) Fotokopje e librezës së punës; (e detyrueshme);
- f) Dëshmi të kualifikimeve; (nese ka)
- g) Vertetim i gjendjes gjyqësore (e detyrueshme);
- h) Vertetin gjykate/prokurorie(e detyrueshme);

(Raporti mjeko – ligjor i tre muajve të fundi ( i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës)

- i) Te kete reference nga punedhens te fushes. (e detyrueshme);

Mosplotësimi i kriterëve të mësipërm si dhe mungesa e një prej dokumentave të detyrueshme, e skualifikon automatikisht kandidatin.

- Vlerësimi i kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për diplomën, përvojën në profesion, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën dhe për intervistën me gojë.

Si eksperiencë në profesion, e cila vlerësohet me max. 10 pikë, do të konsiderohet vetem eksperiencia në pozicionin inxhinier zbatues.

Intervista me gojë do të fokusohet mbi njohuritë profesionale dhe eksperiencen ne pune max 10 pike.

Komisioni i Vlerësimit, brenda 3 (tre) ditë pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe brenda 2 (dy) ditë njofton datën për intervistën me gojë.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës pranë Zyrës së Protokollit të Institucionit nga data 19.06.2023 deri në datën 30.06.2023.

## **SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Në mbështetje të VKM Nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për pozicionin e lirë të punës:

Specialist, kategoria IV-a në Sektorin Juridik në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Kandidati/ja që kërkon të punësohet në këtë vend pune duhet të plotësojë këto kriterë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Fakultetin e Drejtësisë/ Dega Juridik;
4. Niveli i edukimit Master Profesional;
5. Preferohet të ketë eksperiencë pune në profesion të paktën 1 vit;
6. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
7. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 26.06.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Certifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 28.06.2023 do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkursi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e Shërbimit Social Shtetëror që gjendet në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Ligj nr. 44/2015 Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë
2. Ligj nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”
3. VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për Miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”
4. Kodi i Proçedurës Civile i Republikës së Shqipërisë
5. Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar
6. Njohuri për standartet e shërbimeve sociale

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, mund t'i gjeni në adresën [www.sherbimisocial.gov.al](http://www.sherbimisocial.gov.al)

## **SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR** **Njoftim për vend të lirë pune**

Në mbështetje të VKM Nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për pozicionin e lirë të punës:

Specialist, kategoria IV-a në Sektorin e Projekteve në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Kandidati/ja që kërkon të punësohet në këtë vend pune duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë Shkencat Shoqërore.
4. Preferohet të ketë eksperiencë pune për hartimin e projekteve;
5. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
6. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
8. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 26.06.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Certifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 28.06.2023 do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkursi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e Shërbimit Social Shtetëror që gjendet në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Ligji 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”
2. Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.
3. Ligji për “Mbrojtjen e të dhënave personale”

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, mund t'i gjeni në adresën [www.sherbimisocial.gov.al](http://www.sherbimisocial.gov.al)

## **SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR** **Njoftim për vend të lirë pune**

Në mbështetje të VKM Nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për pozicionin e lirë të punës:

Specialist, kategoria IV-b në Sektorin e Projekteve në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Kandidati/ja që kërkon të punësohet në këtë vend pune duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë Shkencat Shoqërore.
4. Preferohet të ketë eksperiencë pune për hartimin e projekteve;
5. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
6. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
8. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 26.06.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Certifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 28.06.2023 do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkursi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e Shërbimit Social Shtetëror që gjendet në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Ligji 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”
2. Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.
3. Ligji për “Mbrojtjen e të dhënave personale”

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, mund t'i gjeni në adresën [www.sherbimisocial.gov.al](http://www.sherbimisocial.gov.al)



---

**ARKIVI QENDROR SHTETËROR I FILMIT**  
**Njoftim për vend të lirë pune**

Sot, më datë 01.06.2023, në mbështetje të dispozitave të Ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Rregullores së Brendëshme të AQSHF, si dhe legjislacionit të R.Sh-së në fuqi, shpallet njoftimi për vend të lirë pune “Teknik i mesëm” në Sektorin e Digitalizimit, Restaurimit, Mirëmbajtjes Teknike në AQSHF si më poshtë:

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë kandidatët e interesuar për t’u punësuar si “Teknik i mesëm” në Sektorin e Digitalizimit, Restaurimit, Mirëmbajtjes Teknike në AQSHF, duhet të paraqesin pranë zyrës së protokollit të Institucionit në një dosje dokumentacionin e mëposhtëm deri më datë 16.06.2023, nga ora 09.00 deri në orën 16.00. Për shkak të vonesave në publikimin e njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, data e re për paraqitjen e dokumentacionit është shtyrë deri më 29.06.2023 nga ora 09.00 deri në orën 16.00.

Dokumentacioni ligjor që duhet të paraqesin kandidatët:

- Kërkesë për t’u punësuar si “teknik i mesëm” në Sektorin e Digitalizimit, Restaurimit, Mirëmbajtjes Teknike në AQSHF
- Të ketë kryer studimet e mesme, brenda ose jashtë vendit.
- Diplomë e përfundimit të shkollës së mesme dhe listë notash të noterizuar.
- Fotokopje e dokumentit të identitetit
- Vërtetim i gjëndjes gjyqësore.
- Raport mjeko-ligjor.
- Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e vërtetuar).
- Kërkesa të posaçme
- Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 2 vjet në institucione të ngjashme
- Të ketë aftësi të mira komunikimi individuale dhe në grup.
- Të ketë njohuri të mira teknike dhe eksperiencë mbi mirëmbajtjen e pompave elektrike dhe kompresorëve elektrikë.

Shpallja e fituesit:

Shpallja e fituesit do të publikohet me anë të një njoftimi në internet, në faqen zyrtare të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit.

**SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**  
**Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për Miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për pozicionin e lirë të punës:

Specialist (Punonjës Social), kategoria IV-b, në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Durrës:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati/ja:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Shkencat Sociale /Dega Punë Sociale;
4. Niveli i edukimit /Master shkencor;
5. Të ketë eksperiencë pune të paktën 1 vit;
6. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
7. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 28.06.2023, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 30.06.2023, do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkursi do të bazohet në njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Ligji nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”;
2. Ligji nr. 8626, dt.22.06.2000” Statusi i Invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”.
3. Ligji nr.7889, datë 14.12.1994, “statusi i Invalidit;
4. Njohuri mbi ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”
5. Ligj Nr.22/2018 “Për strehimin Social”.
6. Vendim nr.135, datë 07.03.2018, “Për miratimin e Statusit të Shërbimit Social Shtetëror”.

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, mund t'i gjeni në adresën [www.sherbimisocial.gov.al](http://www.sherbimisocial.gov.al)

**QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT****Njoftim për vend të lirë pune**

Aplikim për Mjek Transfuziolog ( 2 Mjekë ) me kohë të pjesëshme (Part-Time) në QKTGjakut. Në kuader të projektit RIPRESA AID 0152590/08/02 me një afat kohor 3 vjeçar.

1. Kandidati duhet të plotësojë kushtet për pranim si vijon :
  - a. Të këtë mbaruar studimet e larta universitare në një fakultet të mjekësisë me program të akredituar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë .
  - b. Të këtë mbaruar specializimin pasuniversitar në specialitetin “ Mjekësi Transfuzive”
  - c. Të këtë licencën e ushtrimit të profesionit, lëshuar nga Urdhëri i Mjekut, të vlefshme
  - d. Të këtë mbrojtur gjuhë të huaj
  - e. Të këtë aftësi të mira komunikuese me pacientët, dhuruesit e gjakut dhe personelin e shërbimit
  - f. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim  
Kandidatët duhet të aplikojnë duke dorezuar dokumentat me postë pranë QKTGjakut, Rr Lord Bajron Laprakë, Tiranë.

Lista e dokumentacionit të nevojshëm është :

- a. Jetëshkrimi i kandidatit (CV) (e detyrueshme)
- b. Fotokopje e kartës së identitetit
- c. Certifikatë personale dhe familjare
- d. Diploma Universitare dhe lista e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur nga strukturat përkatëse (e detyrueshme)
- e. Diploma e Specializimit dhe lista e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur nga strukturat përkatëse (e detyrueshme)
- f. Fotokopje e librezës së punës
- g. Dëshmi e kualifikimeve shkencore (grada ose tituj akademik/shkencor)
- h. Dëshmi e njohjes të gjuhës/ve të huaj/a
- i. Certifikatë e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura Brenda dhe jashtë vendit.
- j. Deklarata e gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti e detyrueshme)
- k. Raporti mjeko -ligjor i tre muajve të fundit
- l. Referencë nga punëdhënësi i mëparshëm.

Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose te noterizuara. Dokumentat do te dorezohen me zarf te mbyllur i cili do te protokollohet prane institucionit brenda 5 diteve zyrtare pune nga botimi i ketij njoftimi ne buletin, ne Adresen Qendra Kombetare e Tranzfuzionit te Gjakut, Rr. Lord Bajron, Laprake, Tirane.

Mos paraqitja e te gjitha dokumentave te kerkuara ne origjinal ose fotokopje e noterizuar e skualifikon automatikisht kandidatin.

Pas vleresimit te dokumentacionit kandidatet te cilet i permbushin kriteret e vendosura me siper do ti nenshtrohen nje interviste qe do te zhvillohet ne ambientet e Qendres Kombetare te Transfuzionit te Gjakut.

## **FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA, UNIVERSITETI I TIRANËS**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” të nenit 55, pika 1, gërma p), të Statutit të UT-së të miratuar me Urdhërin Nr. 816, datë 26.12.2018 të MASR, si dhe në mbështetje të vendimit të Bordit të Administrimit Nr.13 datë 07.04.2022 dhe nr 14, datë 07.04.2022, kërkon të punësojë për një vend të lirë pune personel Administrativ me kohë të plotë pranë Njësisë Kryesore si më poshtë:

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për pozicionin vakant “Specialist” në Degën e Financës dhe e Buxhetit.

Kritere të përgjithshme:

1. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurrojnë.
2. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
4. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diploma ekuivalente me to (DIND) në Shkenca Ekonomike.
2. Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike më të avancuara bashkëkohore (programet në fushën e financës).
3. Të ketë dëshmi në një gjuhë të huaj.
4. Të zotërojë aftësi shumë të mira komunikuese dhe e aftë të punojë në grup.

Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës që aplikon.
2. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae)
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të notuar). Për diplomat e marra në universitete e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e notuar e certifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse.
4. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (të notuar).
5. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit.
6. Kopje e librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
7. Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë.

8.Dokument identifikimi.

9.Dëshmi penaliteti.

10. Dëshmi e zotërimit të programeve kompjuterike.(të notuar).

Afati i dorëzimit të dokumentacionit: 10 (dhjetë) ditë pune me ditën e shpalljes në buletin e APP-së.

Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje, provim me shkrim dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Mbi dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për provojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimi, aspiratat dhe pritshmërinë për karrierën.

Për cdo sqarim mund të kontaktoni në numrin e telefonit: +355 42452610

## **QENDRA KOMBËTARE TERAPEUTIKE DHE REHABILITUESE PËR FËMIJËT TIRANË**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Vendimit Nr. 558, datë 15.07.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.325, datë 23.06.2000 “Për Krijimin e Qendrës Kombëtare për Mirëritjen, Zhvillimin dhe Rehabilitimin e fëmijëve”, Urdhërit Nr.671, datë 14.12.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët Tiranë , Shpall:

– 1 (një) vend vakant për pozicionin “Magaznier”

#### **KËRKESA TË POSAÇME:**

1. Të ketë përfunduar Arsimin e Mesëm , Arsimi i Lartë përbën avantazh .
2. Të ketë eksperiencë pune.
3. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.
4. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;

5. Të ketë njohuri të një gjuhe të Bashkimit Europian përbën avantazh .

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

1. Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur në grup, aftësi të mira profesionale, etikë të lartë dhe aftësi të mira komunikuese.
2. Kandidatët duhet të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejnë detyrat përkatëse.
3. Të ketë nënshtetësi Shqipëtare.
4. Të zotërojnë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë.

Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 21 Qershor 2023, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, të institucionit “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët Tiranë”, në adresën: Rruga “ Haki Stermilli, Kombinat, Tiranë.

Kandidatët të cilët vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, do të njoftohen për zhvillimin e intervistës në datë 22.06.2023 në orën 11:00.

**SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK**

**“MBRETËRESHA GERALDINË”**

**Njoftim për vend të lirë pune**

Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, shpall 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin Drejtor Drejtorie Kujdesit të Pacientit/Prokurimeve dhe Shërbimeve Juridike.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriterë:

- Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë;

- Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Preferohen kandidatët që plotësojnë edhe këto kritere të veçanta:

- Të zotërojë diplome të Arsimit të Lartë (Fakulteti i Drejtësisë);
- Të ketë mbi 5 vjet eksperiencë pune në struktura drejtuese;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe e aftë të punojë në grup;
- Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike më të avancuara bashkëkohore (programet në fushën e prokurimeve);
- Të ketë dëshmi në një gjuhë të huaj.

Kandidatët duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

Kërkesë me shkrim për aplikim;

1. Jetëshkrim (CV);
2. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të noterizuara). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
4. Fotokopje e librezës së punës (në të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
5. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnime, kualifikimet, arsimin shtesë etj (nëse ka);
6. Dëshmi e gjuhëve të huaja;
7. Raport mjeko ligjor për aftësi në punë;
8. Dëshmi penaliteti.
9. Reference pune

Dokumentat dorëzohen pranë zyres së protokollit, në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, nga data 19.06.2023 - 30.06.2023. Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Mosplotësimi i kritereve të mësipërm si dhe mungesa e një prej dokumentave të detyrueshme, e skualifikon automatikisht kandidatin.

**BANKA E SHQIPËRISË**  
**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Sigurimi i koleksioneve të muzeut të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare”.

“Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,600,000 Lekë”.



Kandidatët e interesuar mund të pajisen me dokumentet e tenderit, si më poshtë:

- a. Pranë Sektorit të Prokurimit të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Selia Qëndrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë (Ish-Hotel Dajti), Tel: 042 419 411, (ext: 214), çdo ditë me paraqitjen e përfaqësuesit të kandidatit, vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 lekësh, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, sipas detajeve të mëposhtme:  
Përfituesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC  
Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi me objekt: “Sigurimi i koleksioneve të muzeut të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare”; ose
- b. Në formë elektronike, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësuesi i kandidatit, në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë: [avaraku@bankofalbania.org](mailto:avaraku@bankofalbania.org).

Në kërkesë duhet të citohet qartë objekti i prokurimit, emri i subjektit, NIPT-i, të dhënat e kontaktit si: adresa, numri i telefonit dhe e-mail-i ku do të dërgohen dokumentet e tenderit.

Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr. 1, Tiranë, deri më datë 07 Korrik 2023, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## **INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE TIRANË** NJOFTIM

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor - Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Tiranë njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emëftimin dhe vendndodhjen e objektit: RESTAURIMI "KISHA SHEN KOLLIT" KRUTJE E SIPËRME, LUSHNJE”, Monument Kulture i kategorisë së 1-rë.
3. Llojin e punës: "RESTAURIMI KISHA SHEN KOLLIT”, KRUTJE E SIPËRME, LUSHNJE”.
4. Fondi limit i procedurës së konkurrimit 9.895.833(nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë2 nga data e lidhjes së kontratës.



6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 8 ditë nga publikimi i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data 28.06.2023 ora 09:00, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë Rr. "Aleksandër Moisiu" Nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimit publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrimit publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: [www.iktk.gov.al](http://www.iktk.gov.al) në Rubrikën "Rreth nesh/Njoftime".
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. Hapja e ofertave nga Njësia e vlerësimit do të jetë në datë 28.06.2023 ora 11:00 në Autoritetin Kontraktor/Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, kati II, salla e Bibliotekës, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej 7- ditësh nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.

**INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE TIRANË**  
NJOFTIM ANULLIMI

Emri : Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore  
Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, nr.76, ish Kinostudio, Tiranë  
Tel/Fax: 044504152  
E-mail: [info@iktk.gov.al](mailto:info@iktk.gov.al)  
Adresa Web: [www.iktk.gov.al](http://www.iktk.gov.al)

Objekti i procedurës së Konkurrimit publik: ' Restaurimi Kisha Shen Kollit', Krutje e Sipërme, Lushnje.

Publikuar në datë 05.06.2023 në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.51 datë 05.06.2023

Fondi limit: prej 9.895.833 (nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë epesëmijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH

Arsyet e Anulimit: Nuk është paraqitur asnjë ofertë nga asnjë operator ekonomik

**INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE TIRANË**  
NJOFTIM FITUESI

Emri i institucionit: INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Emri i subjektit fitues: "MANE/S" shpk

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore njofton Shoqërinë "MANE/S" shpk, Nipti: J64103865K, Adresa: Lagjia Nr.2, Pallati 46, Sarandë, se:

Oferta e paraqitur më datë 01.06.2023 për kryerjen e punimeve për ndërhyrjet ruajtëse me objekt "Restaurimi Shën Mëhilli-Mingul" Lunxhëri, Gjirokastër në vlerën prej 7,583.333 (shtatë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe vlerën prej 9.047.074 (nëntë milione dyzet e shtatë mijë shtatëdhjetë e katër) lekë me TVSH, është pranuar.

Subjektit fitues "MANE/S" shpk njoftohet për lidhjen e kontratës brenda 5 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe t'i paraqesë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore sigurimin e kontratës në vlerën prej të vlerës së ofertës, të përcaktuar në Dokumentet Standafte të Konkurrimit Publik, më datë 23.06.2023

Në rast se terhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim brenda datës së mësipërme dhe sigurimi i ofertës së konkurimit publik kalon për llogari të institucionit- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore .